



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova
Ministry of Foreign Affairs



MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

AKADEMISË SË STUDIMEVE DIPLOMATIKE TË MESDHEUT ¹

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Akademia e Studimeve Diplomatike e Mesdheut (këtej e tutje të referuar si (“Palët”).

DUKE NJOHUR frymën e bashkëpunimit që ekziston ndërmjet Maltës dhe Kosovës dhe të GATSHËM për të promovuar bashkëpunimin më të ngushtë në trajnimin e diplomatëve;

Kanë rënë dakord si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Objektivi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është që të promovojë kontakte të rregullta dhe bashkëpunim ndërmjet Palëve.

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

Neni 2

Bashkëpunimi

Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informatave dhe përvojave përkitazi me programet e tyre përkatëse të studimit dhe hulumtimit, seminareve dhe aktiviteteve tjera akademike dhe të trajnimit.

Palët mund të eksplorojnë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit në kuadër të objektivave të këtij memorandumi.

Neni 3

Çështjet me interes të përbashkët

Palët do të eksplorojnë mundësinë e shkëmbimit të stazhierëve, ekspertëve dhe hulumtuesve.

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në fushat e studimit dhe hulumtimit, si dhe në shkëmbimin e informatave mbi publikimet kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht në fushat me interes të përbashkët.

Neni 4

Shkëmbimi i informatave

Palët do të shkëmbejnë informata dhe pikëpamje lidhur me trendet ndërkombëtare dhe avancimet në trajnim dhe studime në diplomaci, politikë të jashtme, marrëdhënie ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare, marrëdhënie ekonomike me jashtë, shkenca politike si dhe fusha tjera relevante.

Neni 5

Projektet e ndërmarra bashkërisht

Palët do të nxjerrin protokolle që përcaktojnë termat dhe kushtet të ndonjë projekti të ndërmarrë bashkërisht.

Neni 6

Kushtet financiare

Format, kohëzgjatja dhe kushtet financiare të çfarëdo projekti, shkëmbimeve apo ndonjë veprimtarie tjetër të ndërmarrë në kontekstin e këtij MiM, do të jetë subjekt i marrëveshjes paraprake, me shkrim, ndërmjet Palëve.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur më interpretimin apo zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve nëpërmjet konsultimeve.

Dispozitat e këtij protokollit mund të ndryshohen përmes pëlqimit reciprok me shkrim ndërmjet Palëve.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij, dhe do të vazhdojë të ketë efekt për një periudhë prej tre vjetësh. Pas kësaj, ky mund të ripërtërihet automatikisht për periudha të njëjta, përveç nëse ndërpritet nga ndonjëra Palë, duke dhënë një njoftim me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve Palës tjetër, para datës së përfundimit të Memorandumit. Përfundimi i këtij Memorandumi nuk do të ndikoj në projektet që janë në vazhdim e sipër.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Memorandum.

BËRË në Maltë më 30 Nëntor 2015, në dy kopje origjinale, në Gjuhën Angleze, që janë njëllor autentike.

Për Akademinë Diplomatike
të Republikës së Kosovës
Skender Durmishi, Drejtor

Për Akademinë e Studimeve
Diplomatike të Mesdheut
Stephen Calleya, Drejtor